

Politika globale e Privatësisë

1. Rreth kësaj politike

Sumitomo Electric Group ("ne", "neve" ose "jonë") kemi krijuar këtë Politikë globale të konfidencialitetit (kjo "Politikë") me qëllim përpunimin e duhur të të dhënave personale dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të palëve tona të interesuara (bashkërisht "ju").

Kjo Politikë shpjegon sesi përpunojmë të dhënat tuaja personale bazuar në ligjet që lidhen me përpunimin e të dhënave tuaja personale. Në përputhje me ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe këtë Politikë, ne zotohemi se do t'i menaxhojmë të dhënat tuaja personale që të jenë të sigurta dhe ato të duhura, duke ndjekur me zell parandalimin e përdorimit, shpërndarjes, modifikimit të pa-autorizuar, etj. të të dhënave personale rreth jush.

Ju mund t'u nënshtroheni politikave specifike të ofruara nga Kompanitë e Grupit tonë (siç është përcaktuar edhe më poshtë) apo politika specifike për produkte ose shërbime të caktuara në lidhje me Politikën e përgjithshme. Këto politika specifike të privatësisë do të zëvendësojnë këtë Politikë në mënyrë që klauzolat e përcaktuara në këto politika bien ndesh me klauzolat e përcaktuara në këtë Politikë e Përgjithshme të Privatësisë.

Veçanërisht, nëse ndonjë nga ligjet e vendeve, rajoneve ose shteteve të mëposhtë përmendur janë të zbatueshme atëherë politika e mëposhtme do të ishte gjithashtu e zbatueshme së bashku me Politikën e përgjithshme.

- **Japonia:** [Politika e konfidencialitetit e Japonisë](#)
- **Zona Ekonomike Evropiane (ZEE)/ MB:** [Politika e Konfidencialitetit e ZEE-së dhe Mbretërisë së Bashkuar](#)
- **Kalifornia :** [Shtojca për Aktin e të Drejtave mbi Konfidencialitetin të Kalifornisë](#)

Faqja jonë e internetit mund të ketë përmbajtje edhe nga faqet e internetit të palëve të treta. Këto faqe interneti të palëve të treta dhe çdo shërbim që mund të jetë i aksesueshëm nëpërmjet tyre, kanë politikat e tyre të privatësisë. Nuk mbajmë përgjegjësi për praktikatat e konfidencialitetit të palëve të treta. Ju inkurajojmë që të jeni të vetëdijshëm, se kur largoheni nga faqja jonë e internetit dhe të lexoni politikatat e konfidencialitetit të zbatueshme për këto faqe interneti të palëve të treta.

2. Të dhënat personale të marra nga ne

Kategoritë e të dhënave personale të marra nga ne janë si më poshtë:

- **Të dhënat e identitetit dhe kontaktit**
Emri, mosha, data e lindjes, gjinia, profesioni, adresa, vendi i banimit dhe informacione të tjera të lidhura me detajet e kontaktit, si numri i telefonit, adresa e e-mailit dhe llogaritë e mediave sociale;

- **Të dhënat e produkteve dhe shërbimeve**

Informacion në lidhje me produktet dhe shërbimet që keni blerë (përfshirë produktet dhe shërbimet që keni ndërmend të blini) (përfshirë numrin serial të produktit, detajet e modelit të produktit, informacionin në lidhje me garancitë, informacionin në lidhje me statusin dhe përdorimin e produkteve, informacionin e vendndodhjes, historinë e shërbimit dhe dyqanin e blerjeve);

- **Të dhënat e komunikimit**

Detaje në lidhje me opinionet, kërkesat, pyetjet, përgjigjet e anketës dhe informacione të tjera që keni dhënë;

- **Të dhënat teknike**

Të dhënat teknike duke përfshirë të dhënat e aksesit, adresën e protokollit të internetit (IP), të dhënat tuaja të logimit, llojin dhe versionin e shfletuesit, përcaktimin dhe vendndodhjen e zonës kohore, llojet dhe versionet e shtojcave të shfletuesit, sistemin operativ dhe platformën dhe teknologji të tjera në pajisjet që përdorni për të hyrë në këtë faqe interneti;

- **Të dhënat e përdorimit**

Informacion rreth mënyrës sesi përdorni faqen tonë të internetit, produktet dhe shërbimet;

- **Të dhënat e marketingut**

Preferencat tuaja në marrjen e reklamave nga ne ose palët e treta të angazhuara nga ne dhe preferencat tuaja të komunikimit;

- **Informacion në lidhje me kandidaturat**

Informacioni në lidhje me përvojën, arsimimin dhe verifikimin për të drejtën për punë nëse aplikoni për të punuar për ne;

- Informacioni në lidhje me një individ që është marrë ose drejtuar për të arritur qëllimet e përpunimit të të dhënave personale të përcaktuara në Seksionin 4, dhe

- Informacioni për të cilin dërgojmë një njoftim të veçantë.

Nuk do të marrim ose përdorim informacione të ndjeshme që zbulojnë të dhënat tuaja në lidhje me shëndetin, të dhënat gjenetike, të dhëna në lidhje me orientimin seksual ose të ngjashme, përveç nëse parashikohet në ligje dhe urdhëresa ose nëse pranoni që t'a bëjmë këtë.

Mund t'ju kërkohet të jeni të detyruar të na jepni të dhëna të caktuara sepse dhënia e të dhënave personale kërkohet me statut ose kontratë ose për arsye të tjera. Në këtë rast, nëse nuk jepni të dhënat tuaja personale, mund të mos jemi në gjendje t'ju ofrojmë shërbimin tonë.

3. Si i mbledhim të dhënat tuaja personale

Mund t'i marrim të dhënat personale të përshkruara më lart qoftë drejtpërdrejt nga ju, qoftë nëpërmjet palëve të treta, si kontraktorët, partnerët e biznesit dhe ofruesit e mediave sociale (përfshirë Facebook dhe Google), ashtu edhe nëpërmjet produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga ne.

Më konkretisht, mbledhim dhe përpunojmë të dhënat personale të mëposhtme për ju nga secili prej këtyre burimeve:

1. **Informacioni që na jepni**

Kjo përfshin informacionin rreth jush që na jepni nëpërmjet formularëve të kërkesës në faqen tonë të internetit, ose duke komunikuar me ne, qoftë me e-mail, letër ose forma të tjera.

2. **Informacioni që na japin palët e treta**

Kjo përfshin informacionin rreth jush që palët e treta na japin përmes formularëve të kërkimit në faqen tonë të internetit, ose duke komunikuar me ne, qoftë me e-mail, letër ose forma të tjera.

3. **Informacioni që mbledhim automatikisht nga ju**

Kur vizitoni faqen tonë të internetit, faqja e internetit mbledh automatikisht disa lloje të dhënash që lidhen me ju. Këto lloje të dhënash përfshijnë regjistrat e aksesit, fenerët e internetit (të njohur edhe si piksela), cookies, etj. Këto lloje të dhënash mund të mbeten në kompjuterin tuaj dhe të vazhdojnë të mbledhin të dhëna.

4. Qëllimi i Përpunimit të të Dhënave Personale

Të dhënat personale të mbledhura nga ne përpunohen vetëm nga personeli i autorizuar për detyra specifike brenda qëllimeve të mëposhtme dhe fushëveprimit të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

1. Të dhënat personale të klientëve, furnitorëve, kontraktorëve, partnerëve të biznesit ose përdoruesve të faqes në internet (bashkë "Partnerët e Biznesit")
 - Promovimi i produkteve dhe shërbimeve tona duke përfshirë ofrimin e informacionit të lidhur (siç është shpërndarja e katalogut)
 - Shitjet/furnizimi i produkteve e shërbimeve tona dhe kujdesi / mbështetja e klientit
 - Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve tona
 - Ofrimi i marketingut të drejtpërdrejtë për partnerët potencialë dhe aktual të biznesit në lidhje me produktet, ofertat, promovimet, shpërblimet, ngjarjet dhe shërbimet e ofruara
 - Verifikimi i përshtatshmërisë dhe shpërndarja e çmimeve, në lidhje me kryerjen e promociioneve për Partnerët e Biznesit

- Analiza e historisë së shfletimit të Partnerëve të Biznesit që na kanë ofruar përmes faqes sonë të internetit dhe mediave sociale, dhe informacione të tjera të këtyre partnerëve të biznesit, duke u ofruar atyre informacion për produktet që plotësojnë preferencat dhe shijet e tyre
 - Analiza e numrit të hyrjeve të kryera në faqen fillestare siç është vendosur përmes reklamave tona, duke u përpjekur në këtë mënyrë të përmirësojmë përmbajtjen dhe vendosjen e reklamave
 - Përbushja e çdo qëllimi tjetër biznesi ose tregtar në drejtimin e Partnerëve të Biznesit, ose me njoftim dhe/ose pëlqim për këtë
 - Realizimi i kontratave me Partnerët e Biznesit
 - Angazhimi në negociata biznesi, takime ose forma të tjera komunikimi me Partnerët e Biznesit (përfshirë regjistrimin audio dhe regjistrimin video të përmbajtjes së takimeve të tilla, etj.)
 - Përgjigja ndaj komenteve, pyetjeve dhe kërkesave nga Partnerët e Biznesit, ofrimi i shërbimit post asistence dhe përndryshe kryerja e shërbimeve të kërkuara nga Partnerët e Biznesit
 - Kryerja e anketave me pyetësor të Partnerëve të Biznesit dhe analiza e rezultateve përkatëse
2. Të dhënat personale të aksionereve
- Ushtrimi i të drejtave dhe përbushja e detyrimeve sipas ligjeve ose rregulloreve në fuqi të përcaktuara me to
 - Ofrimi i shërbimeve
 - Zbatimi i masave të ndryshme për aksionerët
 - Menaxhimi i informacionit të aksionerëve bazuar në ligje dhe rregullore, duke përfshirë krijimin e bazave të të dhënave
3. Të dhënat personale të aplikantëve për punësim
- Sigurimi i informacionit të punësimit për aplikantët dhe komunikimi me ta në lidhje me procedurat e përzgjedhjes, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet universiteteve apo agjencive të tyre të punësimit
 - Shqyrtimi nëse do të punësohen apo jo aplikantët
 - Menaxhimi i aplikantëve të cilëve u është ofruar punësimi, si dhe kryerja e procedurave të tjera lidhur me aplikantët për punësim
4. Qëllimet e përbashkëta të përdorimit për të gjitha të dhënat personale
- Parandalimi dhe reagimi ndaj mashtrimit, shkeljes së politikave dhe rregullave përkatëse, kërcënimeve dhe dëmeve
 - Funkionimi, menaxhimi dhe përmirësimi i faqes sonë të internetit, llogarive të mediave sociale, aplikacioneve, aktiviteteve të marketingut, produkteve dhe shërbimeve

- Analiza të të dhënave për aksesin në faqen tonë të internetit dhe përmbajtjet e saj dhe shpejtësinë e aksesit në to, duke u përpjekur në këtë mënyrë të përmirësojmë faqen tonë të internetit dhe përmbajtjet e saj dhe të përmirësojmë sistemet dhe serverat tanë
- Çdo qëllim tjetër i njoftuar individualisht ose i shpallur publikisht në masën që kërkohet nga ligjet dhe rregulloret në fuqi

5. Baza Ligjore

Do t'i përpunojmë të dhënat tuaja personale në përputhje me bazën ligjore të kërkuar nga ligjet dhe rregulloret në fuqi. Baza ligjore për përpunimin e të dhënave tuaja personale mund të ndryshojë në varësi të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të juridiksioneve përkatëse.

6. Shpërndarja e të dhënave personale për marrësit

Nuk do të shesim, marrim me qira ose japim me qira të dhënat tuaja personale. Mund të shpërndajmë të dhënat tuaja personale marrësve të përshkruar si më poshtë ose të përshkruar në politikat specifike në masën e nevojshme për të ndjekur qëllimet e përpunimit të të dhënave personale të përcaktuara në Seksionin 4 dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

1. Kompanitë e Grupit

Filialet dhe subjektet e lidhura të Sumitomo Electric Industries, Ltd. të renditura në, por pa u kufizuar në, në [lidhjen](#) e mëposhtme ("Kompanitë e Grupit").

2. Ofruesit e Shërbimeve

Furnitorët e shërbimeve, si furnitorët e shërbimeve të internetit, furnitorët e shërbimeve të analitikës në internet, furnitorët e shërbimeve cloud, shitësit e softuerëve, furnitorët e shërbimeve të analitikës statistikore të shitjeve, agjencitë e rekrutimit ose punësimit, këshilltarët profesionistë ose konsulentët.

3. Të tjera

Partnerët e mundshëm të bashkimit dhe blerjes, autoritetet ligjore ose rregullatore, ose palë të tjera të treta.

7. Transfertat ndërkuftare

Jemi të angazhuar në aktivitete biznesi në shkallë globale dhe në disa raste do t'i transferojmë të dhënat tuaja personale në një vend ose rajon që nuk ka ligje dhe rregullore dhe të ngjashme për mbrojtjen e të dhënave, të barasvlershme me ato që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale në vendin ose rajonin ku banoni. Me transferimin e të dhënave tuaja personale jashtë vendit, do të marrim masat e duhura në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligjet dhe rregulloret në fuqi.

8. Limiti i arkivimit të të dhënave personale

Nëse nuk ka udhëzime të tjera, do t'i ruajmë të dhënat personale që mbledhim për ju për periudhën e nevojshme për të përpunuar të dhëna të tilla personale, përveç në masën që na kërkohet me ligj që t'i mbajmë të dhënat për një periudhë më të gjatë kohore, në këtë rast do t'i ruajmë për periudhën e kërkuar me ligj.

Për të përcaktuar periudhën e duhur të ruajtjes të të dhënave personale, mbajmë parasysh sasinë, natyrën dhe ndjeshmërinë e të dhënave personale, rrezikun e mundshëm të dëmtimit nga përdorimi i pa-autorizuar ose shpërndarjen e të dhënave tuaja personale, qëllimet për të cilat përpunojmë të dhënat tuaja personale dhe nëse mund t'i arrijmë këto qëllime nëpërmjet mjeteve të tjera dhe kërkesave ligjore në fuqi.

9. Të drejtat tuaja

Në varësi të vendit ku banoni, mund të keni një sërë të drejtash ligjore në lidhje me të dhënat personale që mbajmë për ju. Këto të drejta mund të ndryshojnë në varësi të vendit ku banoni dhe ligjeve për mbrojtjen e të dhënave që do të zbatohen për marrëdhëniet mes jush dhe nesh, por zakonisht përfshijnë:

1. të drejtën për të marrë informacion në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale dhe aksesin në të dhënat personale që mbajmë për ju;
2. të drejtën për të kërkuar që të korrigjojmë të dhënat tuaja personale nëse janë të pasakta ose të paplota;
3. të drejtën për të kërkuar që të fshijmë të dhënat tuaja personale;
4. të drejtën për të kërkuar që të kufizojmë përpunimin e të dhënave tuaja personale;
5. të drejtën për të na kundërshtuar përpunimin nga ana jonë të të dhënave tuaja personale;
6. të drejtën për të tërhequr pëlqimin tuaj për përpunimin tonë të të dhënave tuaja personale. (Kjo e drejtë ekziston vetëm kur mbështetemi në pëlqimin për të përpunuar të dhënat tuaja personale. Tërheqja e pëlqimit nuk do të ndikojë në ligjshmërinë e përpunimit bazuar në pëlqimin përpara tërheqjes së tij.)

Për sa kohë që kërkesa juaj për të ushtruar të drejtat tuaja është brenda fushëveprimit të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, mund t'i ushtroni të drejtat tuaja duke na kontaktuar duke përdorur informacionin rreth nesh në Seksionin 12 më poshtë. Ju lutemi vini re se mund t'ju ngarkojmë një tarifë të arsyeshme për përpunimin e kërkesës tuaj kur lejohet nga ligji në fuqi për mbrojtjen e të dhënave. Gjithashtu, kini parasysh se mund t'ju duhet të na dërgoni informacion shtesë për të verifikuar identitetin tuaj përpara se të përpunojmë kërkesën tuaj.

10. Siguria

Për të mbrojtur të dhënat tuaja personale kundër shkatërrimit ose ndryshimit aksidental apo të paligjshëm, humbjes, përdorimit ose ndryshimit kundër shpërndarjes ose aksesit të paautorizuar, përdorim masat e duhura organizative, njerëzore, fizike dhe teknike të sigurisë.

11. Ndryshimet në këtë politikë

Mund ta modifikojmë këtë politikë herë pas here dhe do të postojmë politikën e përditësuar me një datë efektive "Përditësimi i fundit" për rishikimet. Ju rekomandojmë që t'a shqyrtoni këtë politikë në mënyrë periodike. Nëse bëjmë një ndryshim material në këtë politikë, do t'ju japim njoftimin i duhur, për shembull një njoftim i postuar në faqen tonë të internetit.

12. Informacion Rreth Nesh

1. **Emri i kontrolluesit:** Sumitomo Electric Industries, Ltd.
2. **Adresa e zyrës kryesore:** 4-5-33, Kitahama, Chuo-ku, Osaka City, Osaka, Japoni
3. **Emri i shefit të menaxherit të të dhënave personale:** [Ju lutemi klikoni këtu](#).
4. **Formulari i Kërkesës:** [Ju lutemi klikoni këtu](#)

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë politikë, të drejtat tuaja ose ndonjë çështje tjetër në lidhje me mbrojtjen e të dhënave tuaja personale, mund të na kontaktoni duke përdorur Formularin e Kërkimit të mësipërm.

Data e hyrjes në fuqi: 14 Prill 2023

Përditësimi i fundit: 14 prill 2023

POLITIKA E PRIVATËSISË EEA dhe Mbretërinë e Bashkuar

1. RRETH KËSAJ POLITIKE

Kjo politikë zbatohet për ju (a) nëse ndërveproni me Sumitomo Electric Industries, Ltd. ("SEI") dhe nese ju jeni me seli në Zonën Ekonomike Evropiane ("ZEE ") ose në Mbretërinë e Bashkuar (MB) ose (b) nëse ndërveproni me filialet e SEI dhe subjektet e lidhura (të listuara, por pa u kufizuar, në [lidhjen](#) e mëposhtme, "**Kompanitë e Grupit**") me seli në ZEE ose në MB ose (c) nëse ligji për mbrojtjen e të dhënave të EEA ose MB zbatohet ndryshe. Kjo politikë, e cila duhet të lexohet së bashku me [Politikën tonë të Privatësisë Globale](#), përshkruan se si do t'i përdorim të dhënat tuaja kur ndërveproni me ne dhe faqet tona të internetit, dhe kur ju merrni komunikime nga ne ose komunikoni në mënyra të ndryshme me ne, kur organizata juaj është partneri ynë i biznesit dhe kur na drejtoheni / aplikoni tek ne. Lista e personave përgjegjës apo kontrollorëve të mbrojtjes së të dhënave personale dhe detajet e tyre të kontaktit mund të gjenden në seksionin "[Na kontaktoni](#)". Një referencë për "ne" ose "ne" është një referencë për SEI dhe Kompanitë e Grupit të përfshira në përpunimin e të dhënave personale. Në disa raste, ne mund të ofrojmë politika shtesë të privatësisë specifike kjo për produkte, shërbime dhe zona të veçanta. Ato politika specifike të privatësisë do ta zëvendësojnë këtë politikë në mënyrë që klauzolat e përcaktuara në ato politika bien ndesh me klauzolat e përcaktuara në politikën e përgjithshme të privatësisë. Kjo politikë përshkruan gjithashtu të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë të drejtën për të kundërshtuar disa nga përpunimet që ne kryejmë. Më shumë informacion në lidhje me të drejtat tuaja dhe mënyrën e ushtrimit të tyre, përcaktohen në seksionin "[Të drejtat tuaja](#)".

2. Përmbledhje e mënyrës se si ne i përdorim të dhënat tuaja

- Ne përdorim të dhënat tuaja personale për qëllimet e përshkruara në këtë politikë, të tilla si promovimi, shitja dhe furnizimi i produkteve dhe shërbimeve tona, menaxhimi i marrëdhënieve tona me ju dhe rekrutimi.
- Të dhënat ndahen me kompanitë tona të Grupit për qëllime administrative dhe për përdorime të përshkruara në këtë politikë. Ne gjithashtu mund t'i ndajmë të dhënat tuaja personale me ofruesit tanë të shërbimeve, të tilla si ofruesit e shërbimeve të internetit, ofruesit e shërbimeve analitike në ueb, ofruesit e shërbimeve cloud, shitësit e softuerëve, ofruesit e shërbimeve të analitikës statistikore të shitjeve, agjencitë e rekrutimit ose punësimit, këshilltarët ose konsulentët profesionistë. Ne mund të ndajmë të dhënat tuaja personale me partnerët tanë potencial në rast bashkimi dhe blerjeje, autoritete ligjore dhe / ose rregullatore.
- Për shkak të natyrës globale të biznesit tonë, të dhënat tuaja personale do t'u komunikohen kompanive të grupit jashtë territoreve të EEA dhe MB, veçanërisht në Japoni si një kompani me seli në Japoni. Komisioni Evropian dhe qeveria e Mbretërisë së Bashkuar kanë përcaktuar se Japonia ofron një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje – mund të mësoni më shumë në vendim(et) e përshtatshmërisë [këtu](#) dhe [këtu](#). Ne mbështetemi në këto vendime për transfertat EEA-Japoni dhe MB-Japoni.
- Aty ku ne mbështetemi në pëlqimin tuaj, ju mund ta tërhiqni këtë pëlqim në çdo kohë.

3. Të dhënat personale të marra nga ne

Ne mbledhim dhe përpunojmë të dhëna personale për ju kur ndërveproni me ne dhe faqet tona të internetit, dhe kur merrni komunikime nga ne ose komunikoni në mënyra të tjera me ne, kur organizata juaj është partneri ynë i biznesit dhe kemi marrëdhënie me ju në atë cilësi, dhe nëse aplikoni tek ne. Kjo përfshin:

- **Të dhënat e identitetit dhe kontaktit-**

Emri, mosha, data e lindjes, gjinia, profesioni, adresa, vendi i banimit dhe informacione të tjera në lidhje me detajet e kontaktit, si numri i telefonit, si dhe adresa e emailit dhe llogaritë e mediave sociale;

- **Të dhënat e produkteve dhe shërbimeve**

Informacion në lidhje me produktet dhe shërbimet që ka blerë organizata juaj;

- **Të dhënat e komunikimit**

Detaje në lidhje me opinionet, kërkesat, pyetjet, përgjigjet e anketës dhe informacionet e tjera që ju keni dhënë;

- **Të dhënat teknike**

Të dhënat teknike duke përfshirë të dhënat e aksesit, adresën e protokollit të internetit (IP), të dhënat tuaja të hyrjes, llojin dhe versionin e shfletuesit, përcaktimin dhe vendndodhjen e zonës kohore, llojet dhe versionet e shtojcave të shfletuesit, sistemin operativ dhe platformën dhe teknologji të tjera në pajisjet që përdorni për të hyrë këtë faqe interneti;

- **Të dhënat e përdorimit**

Informacion rreth mënyrës se si e përdorni faqen tonë të internetit, produktet dhe shërbimet;

- **Të dhënat e marketingut**

Preferencat tuaja në marrjen e marketingut nga ne dhe palët e treta të angazhuara nga ne dhe preferencat tuaja të komunikimit; dhe

- **Informacion në lidhje me aplikacionin**

Informacioni në lidhje me përvojën, arsimin dhe të drejtën për punë kontrollon nëse aplikoni për të punuar për ne.

Ne nuk do të marrim ose përdorim informacione sensitive që zbulojnë të dhënat tuaja në lidhje me shëndetin, të dhënat gjenetike, të dhënat në lidhje me orientimin seksual ose të ngjashme, përveç rasteve ku parashikohet në ligje dhe urdhëresa ose ju pranoni që ne ta bëjmë këtë.

Mund t'ju kërkohet të na jepni të dhëna të caktuara sepse dhënia e të dhënave personale kërkohet me statut ose kontratë, ose është e nevojshme për të lidhur një kontratë me ne. Në këtë rast, nëse nuk jepni të dhënat tuaja personale, ne mund të mos jemi në gjendje t'ju ofrojmë shërbimin tonë.

4. Si i mbledhim të dhënat tuaja personale

Ne mund t'i marrim të dhënat personale të përshkruara më sipër si drejtpërdrejt nga ju ashtu edhe nëpërmjet palëve të treta, si kontraktorët, partnerët e biznesit dhe ofruesit e mediave sociale (duke përfshirë Facebook dhe Google). Vecanërisht, ne mbledhim dhe përpunojmë të dhënat personale të mëposhtme për ju nga secili prej këtyre burimeve:

1. Informacioni që ju na jepni.

Kjo përfshin informacionin rreth jush që na jepni përmes formularëve / pyetesoreve në faqen tonë të internetit, ose duke komunikuar me ne, qoftë kjo nëpërmjet postës elektronike (me e-mail), letër ose forma të tjera. Informacionet që ju na jepni ka të ngjarë të përfshijnë të dhënat tuaja të kontaktit si emrin, adresën, adresën e e-mailit, numrin e telefonit.

2. Informacionet që na japin palët e treta.

Kjo përfshin informacionin rreth jush që palët e treta na japin përmes formularëve të kërkimit në faqen tonë të internetit, ose duke komunikuar me ne, qoftë me e-mail, letër ose në mënyrë tjetër. Nëse aplikoni tek ne, ne mund të mbledhim informacione lidhur me aplikimin nga palët e treta, duke përfshirë gjyqtarët dhe njerëzit me të cilët intervistojmë. Nëse organizata juaj është partneri ynë i biznesit, ne gjithashtu mund të mbledhim informacionin tuaj personal nga organizata juaj. Informacioni që na japin palët e treta ka të ngjarë të përfshijë informacionin tuaj të kontaktit si emrin, adresën, adresën e e-mailit, numrin e telefonit.

3. Informacion që ne mbledhim automatikisht nga ju.

Kur vizitoni faqen tonë të internetit, faqja e internetit mbledh automatikisht disa lloje të dhënash që lidhen me ju. Këto lloje të dhënash përfshijnë regjistrat e aksesit, fenerët e uebit (të njohur edhe si pikselë), cookies, etj. Këto lloje të dhënash mund të mbeten në kompjuterin tuaj dhe të vazhdojnë të mbledhin të dhëna.

Ne gjithashtu mund të mbledhim, përdorim dhe ndajmë të dhëna të grumbulluara si të dhëna statistikore ose demografike për çdo qëllim. Të dhënat e grumbulluara mund të rrjedhin nga të dhënat tuaja personale, por sipas ligjit nuk konsiderohen të dhëna personale pasi këto të dhëna nuk zbulojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi identitetin tuaj. Për shembull, ne mund të grumbullojmë të dhënat tuaja të përdorimit për të llogaritur përqindjen e përdoruesve që hyjnë në një veçori specifike të faqes së internetit. Megjithatë, nëse kombinojmë ose lidhim të dhënat e grumbulluara me të dhënat tuaja personale në mënyrë që të mund t'ju identifikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi, ne i trajtojmë të dhënat e kombinuara si të dhëna personale që do të përdoren në përputhje me këtë politikë.

5. Qëllimi i Përpunimit të të Dhënave Personale dhe Baza Ligjore

Ne mund t'i përdorim të dhënat tuaja personale vetëm për qëllimet dhe bazat ligjore të përcaktuara më poshtë:

Qëllimi/Veprimtaria	Lloji i të dhënave	Baza e ligjshme për përpunim
Për të regjistruar informacionet e kontaktit të biznesit	(a) Identiteti dhe kontakti	E nevojshme për interesat tona legjitime (për të menaxhuar marrëdhëniet tona me ju ose organizatën tuaj dhe për të mbajtur të dhënat tona të përditësuara)
Për të operuar, zhvilluar ose përmirësuar produktet, shërbimet dhe faqet tona të internetit.	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Produktet dhe Shërbimet (c) Komunikimet (d) Teknike (e) Përdorimi (f) Marketingu	E nevojshme për interesat tona legjitime (për të përmbushur kontratën tonë me një partner biznesi; për të operuar, zhvilluar ose përmirësuar produktet, shërbimet dhe faqet tona të internetit për të përmbushur nevojat e partnerëve tanë të biznesit)
Për të përpunuar dhe dorëzuar porositë e organizatës suaj, midis të tjerash : (a) Administrimi i pagesave, tarifave dhe vlerave -detyrimet (b) Mbledhja dhe rikuperimi i parasë që na detyrohen	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Produktet dhe Shërbimet (c) Komunikimet (d) Marketingu	E nevojshme për interesat tona legjitime (për të përmbushur kontratën tonë me një partner biznesi; për të zhvilluar marrëdhënien tonë me partnerin e biznesit; dhe për të rikuperuar borxhet që na detyrohen)
Për të menaxhuar marrëdhënien tonë me ju, e cila përfshin: (a) Ju njoftojmë për ndryshimet e kryera në kushtet tona ose politikën e privatësisë (b) Duke ju kërkuar të lini një rishikim ose të bëni një anketë	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Produktet dhe Shërbimet (c) Komunikimet (d) Marketingu	(a) E nevojshme për të përmbushur një detyrim ligjor (siç janë ligjet për mbrojtjen e të dhënave, ligjet tatimore dhe detyrime të ngjashme) (b) E nevojshme për interesat tona legjitime (për të mbajtur të dhënat tona të përditësuara dhe për të studiuar se si klientët përdorin produktet/shërbimet tona)
Për t'ju mundësuar të merrni pjesë në një tërheqje çmimesh, konkurrim ose plotësoni një anketë	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Produktet dhe Shërbimet (c) Përdorimi (d) Komunikimet (e) Marketingu	(a) E nevojshme për interesat tona legjitime (për të studiuar se si klientët përdorin produktet/shërbimet tona, për t'i zhvilluar ato dhe për të rritur biznesin tonë)
Për të administruar dhe mbrojtur biznesin tonë dhe këtë faqe interneti (përfshirë zgjidhjen e problemeve, analizën e të dhënave, testimin, mirëmbajtjen e sistemit, mbështetjen, raportimin dhe pritjen e të dhënave)	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Teknik (d) Përdorimi	(a) E nevojshme për interesat tona legjitime (për administrimin e biznesit tonë, ofrimin e shërbimeve Administrative dhe Informatike , sigurinë e rrjetit, për të parandaluar mashtrimin dhe në kontekstin e një riorganizimi biznesi ose ristrukturimi grupor) (b) E nevojshme për të përmbushur një detyrim ligjor (siç është mbrojtja e të dhënave dhe detyrime të ngjashme)
Për të ofruar përmbajtje të faqes së internetit dhe reklama përkatëse dhe për të matur ose kuptuar efektivitetin e reklamave që ju ofrojmë	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Produktet dhe Shërbimet (c) Komunikimet (d) Teknike (e) Përdorimi (f) Marketingu	E nevojshme për interesat tona legjitime (për të studiuar se si klientët përdorin produktet/shërbimet tona, për t'i zhvilluar ato, për të rritur biznesin tonë dhe për të informuar strategjinë tonë të marketingut)
Për të përdorur të dhënat analitike për të përmirësuar faqen tonë të internetit, produktet/shërbimet, marketingun, marrëdhëniet me klientët dhe përvojat tona	(a) Teknik (b) Përdorimi	E nevojshme për interesat tona legjitime (për të përcaktuar llojet e klientëve për produktet dhe shërbimet tona, për të mbajtur faqen tonë të internetit të përditësuar dhe me informacionet përkatëse, për të zhvilluar biznesin tonë dhe për të informuar strategjinë tonë të marketingut)
Për t'iu bërë sugjerime dhe rekomandime për mallrat ose shërbimet që mund të jenë	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Produktet dhe shërbimet	E nevojshme për interesat tona legjitime (për të zhvilluar produktet/shërbimet tona dhe për

me interes për ju	(c) Komunikimet (d) Teknike (e) Përdorimi (f) Marketingu	të rritur biznesin tonë)
Për t'u ofruar informacione mbi punësimin aplikantëve dhe komunikimi me ta në lidhje me procedurat e përzgjedhjes, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet universiteteve apo agjencive të tyre të punësimin	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Komunikimet (c) Informacion në lidhje me aplikimin	E nevojshme për interesat tona legjitime (për të siguruar që ne rekrutojmë kandidatë të mundshëm.)
Të shqyrtojë nëse do të punësojë apo jo aplikantët dhe të menaxhojë aplikantët të cilëve u është ofruar punësim dhe të kryejë procedura të tjera në lidhje me aplikantët për punësim	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Komunikimet (c) Informacion në lidhje me aplikimin	E nevojshme për interesat tona legjitime (për të siguruar që ne rekrutojmë kandidatë të mundshëm.)
Për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur mashtrimit, shkeljes së politikave dhe rregullave përkatëse, kërcënimeve dhe dëmeve	(a) Identiteti dhe kontakti, (b) Produktet dhe shërbimet, (c) Teknik (d) Përdorimi	E nevojshme për interesat tona legjitime (për të parandaluar mashtrimin dhe për të mbrojtur interesat dhe të drejtat tona të biznesit, ose të individëve dhe publikut.)

6. Shpërndarja e të dhënave personale për marrësin

Të dhënat personale do të përpunohen kryesisht nga punonjësit e ekipit tonë te faqes së internetit, departamentet e biznesit, departamentet e IT dhe financave dhe ekipi ynë i burimeve njerëzore nëse aplikoni tek ne. Ne mund t'ua shpërndajmë / të dhënat tuaja personale marrësve të përshkruar si më poshtë.

1. **Kompanitë e grupit** (filiale dhe subjekte të lidhura me SEI të listuara, por pa u kufizuar në, në [lidhjen](#) e mëposhtme). Ne ndajmë të dhënat tuaja personale me kompanitë tona të Grupit globalisht për qëllime të brendshme administrative dhe për përdorime që janë në përputhje me këtë politikë. Në veçanti, ne ndajmë informacionin tuaj të kontaktit si adresat, emrat, emrat e kompanive tuaja, numrat e telefonit, adresat e e-mailit ose komentet në formularin e kërkesës me Kompanitë tona të Grupit. Këto kompani të grupit do të përdorin të dhënat personale për: (i) ofrimin e produkteve ose shërbimeve që ju i keni kërkuar kompanisë t'ju japë, (ii) të përmirësojë produktet ose shërbimet tona, (iii) të promovojë produktet ose shërbimet tona, ngjarjet dhe fushatat e marketingut, ose të kryejë sondazhe dhe analiza të marketingut, dhe (iv) të zhvillojë produkte ose shërbime të reja. SEI është përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave personale të ndara me Kompanitë e Grupit.

2. **Ofruesit e Shërbimeve.** Ne mund t'i ndajmë të dhënat tuaja personale me ofruesit e shërbimeve, të tilla si; ofruesit e shërbimeve të internetit, ofruesit e shërbimeve analitike në internet, ofruesit e shërbimeve cloud, shitësit e softuerëve, ofruesit e shërbimeve të analizave statistikore të shitjeve, agjencitë e rekrutimit ose punësimit, këshilltarët profesionistë ose konsulentët.
3. **Të tjerët.** Ne mund t'i ndajmë të dhënat tuaja personale me partnerë të rëndësishëm të mundshëm të bashkimit dhe blerjes, ose me autoritetet ligjore ose rregullatore.

Të dhënat personale mund të ndahen me autoritetet qeveritare dhe/ose zyrtarët e zbatimit të ligjit nëse kërkohet për qëllimet e mësipërme, nëse kërkohet me ligj ose nëse kërkohet për mbrojtjen ligjore të interesave tona legjitime në përputhje me ligjet në fuqi.

Ju lutemi shikoni kategoritë përkatëse të të dhënave personale më poshtë:

Marrësi	Kategoria
Kompanitë e Grupit	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Produktet dhe Shërbimet (c) Komunikimet (d) Teknike (e) Përdorimi (f) Marketingu (g) Informacion në lidhje me aplikimin
Ofruesit e Shërbimeve	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Komunikimet (c) Teknik (d) Përdorimi (e) Marketingu
Të tjerët (partnerë të rëndësishëm të mundshëm të bashkimit dhe blerjes, ose autoritetet ligjore ose rregullatore)	(a) Identiteti dhe kontakti (b) Produktet dhe Shërbimet (c) Komunikimet (d) Teknike (e) Përdorimi (f) Marketingu (g) Informacion në lidhje me aplikimin

7. Transfertat ndërkuftare

Për shkak të natyrës globale të biznesit tonë, të dhënat tuaja personale do t'iu komunikohen kompanive të grupit jashtë EEA dhe MB, duke përfshirë, veçanërisht Japoninë si një kompani që ka vendodhjen në Japoni. Komisioni Evropian dhe qeveria e Mbretërisë së Bashkuar kanë përcaktuar se Japonia ofron një nivel të përshtatshëm dhe adekuat mbrojtjeje – mund të mësoni më shumë në vendim(et) e përshtatshmërisë [këtu](#) dhe [këtu](#). Ne mbështetemi në këto vendime për transfertat EEA-Japoni dhe MB-Japoni.

Ne gjithashtu transferojmë të dhënat tuaja personale te disa palë të treta të cilat strehojnë ose aksesojnë të dhënat personale jashtë ZEE dhe MB. Aty ku këto seli vendndodhje nuk ofrojnë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave, ne sigurojmë marrjen e masave të duhura mbrojtëse për të mbrojtur transferimin e të dhënave tuaja personale nga përdoruesit në këto vende. Disa nga këto vende i nënshtrohen një vendimi të Komisionit Evropian për përshtatshmërinë. Për vendet e tjera, ne kemi vënë në zbatim klauzolat standarde kontraktuale të miratuara nga Komisioni Evropian brenda kompanive të grupit ose me palën e tretë përkatëse për të mbrojtur këto të dhëna personale. Ne mbështetemi gjithashtu në mekanizma të tjerë të lejuara për transferimin e të dhënave, të tilla si mbështetja në rregullat përkatëse të korporatës së palëve të treta (të miratuara nga autoritetet e BE-së për mbrojtjen e të dhënave të vëna në zbatim për të mbrojtur të dhënat tuaja personale).

Një kopje e mekanizmit përkatës mund të merret për shqyrtimin tuaj sipas kërkesës duke përdorur të dhënat e kontaktit më poshtë.

8. Limiti i ruajtjes për të dhënat personale

Nëse nuk tregohet ndryshe, ne do t'i ruajmë të dhënat personale që mbledhim për ju për periudhën e nevojshme për të përpunuar të dhëna të tilla personale. Për të përcaktuar periudhën e duhur të ruajtjes së të dhënave personale, ne konsiderojmë sasinë, natyrën dhe ndjeshmërinë e të dhënave personale, rrezikun e mundshëm të dëmtimit nga përdorimi i paautorizuar ose shpërndarja e të dhënave tuaja personale, qëllimet për të cilat ne përpunojmë të dhënat tuaja personale dhe nëse ne mund ti arrijmë këto qëllime nëpërmjet mjeteve të tjera, dhe kërkesave ligjore në fuqi. Në përgjithësi, ne do t'i mbajmë të dhënat për një periudhë 6 vjeçare nga momenti në të cilin nuk nevojiten më, përveç rasteve kur ka procedura apo çështje ligjore përkatëse për të cilat të dhënat kërkohen në mënyrë të arsyetuar te nevojshme. Pas kësaj periudhe, ne do të ndërmarrim hapa për të fshirë të dhënat tuaja personale ose për t'i mbajtur ato në një formë që nuk ju identifikon më.

9. Të drejtat tuaja

Ju keni një sërë të drejtash ligjore në lidhje me të dhënat personale që ne mbajmë për ju. Këto të drejta përfshijnë:

1. të drejtën për të marrë informacion në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale dhe aksesin në të dhënat personale që ne mbajmë për ju;
2. të drejtën për të kërkuar që ne të korrigjojmë të dhënat tuaja personale nëse janë të pasakta ose të paplota;
3. të drejtën për të kërkuar që ne të fshijmë të dhënat tuaja personale;
4. të drejtën për të marrë të dhënat personale që ju na ofroni në një format të strukturuar dhe të lexueshëm mekanikisht.
5. të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave tuaja personale në disa rrethana (në veçanti, kur nuk kemi nevojë t'i përpunojmë të dhënat për të përmbushur një kërkesë kontraktuale ose një kërkesë tjetër ligjore);
6. të drejtën për të na kundërshtuar për përpunimin nga ana jonë të të dhënave tuaja personale;
7. të drejtën për të tërhequr pëlqimin tuaj për përpunimin tonë të të dhënave tuaja personale. (Kjo e drejtë ekziston vetëm kur ne mbështetemi në pëlqimin për të përpunuar të dhënat tuaja personale. Tërheqja e pëlqimit nuk do të ndikojë në ligjshmërinë e përpunimit bazuar në pëlqimin përpara tërheqjes suaj .)

Ju mund të ushtroni të drejtat tuaja duke na kontaktuar në detajet e kontaktit të përcaktuara në seksionin "[Na kontaktoni](#)". Gjithashtu, kini parasysh që mund t'ju nevojitet të dërgoni informacion shtesë për të verifikuar identitetin tuaj përpara se të përpunojmë kërkesën tuaj.

Këto të drejta mund të jenë të kufizuara, për shembull nëse përmbushja e kërkesës suaj do të zbulonte të dhëna personale për një person tjetër, ose nëse na kërkoni të fshijmë informacionin që na kërkohet nga ligji ose kemi interesa legjitime bindëse për t'i mbajtur.

Në disa raste, ne jemi në gjendje t'ju dërgojmë marketing të drejtpërdrejtë pa pëlqimin tuaj, ku ne mbështetemi në interesat tona legjitime. Ju keni të drejtën absolute për të hequr dorë nga marketingu i drejtpërdrejtë, ose profilizimi që ne kryejmë për marketing të drejtpërdrejtë, në çdo kohë. Ju mund ta bëni këtë duke ndjekur udhëzimet në komunikimin ku ky është një mesazh elektronik, ose duke na kontaktuar duke përdorur detajet e përcaktuara më poshtë.

Nëse keni shqetësime të pazgjidhura, keni të drejtë të ankoheni tek një autoritet i mbrojtjes së të dhënave në vendin ku jetoni, punoni ose ku besoni se ka ndodhur një shkelje.

10.Ndryshimet në këtë Politikë të Privatësisë

Ne mund ta modifikojmë këtë politikë herë pas here dhe do të postojmë politikën e përditësuar me "Përditësimi i fundit" si dhe datën efektive të rishikimeve. Ne ju rekomandojmë që ta rishikoni këtë politikë në mënyrë periodike. Ne do t'ju ofrojmë një njoftim të ri privatësie kur të bëjmë ndonjë përditësim thelbësor. Ne gjithashtu mund t'ju njoftojmë herë pas here në mënyra të tjera për përpunimin e të dhënave tuaja personale.

11.Na kontaktoni

Informacioni juaj kontrollohet nga SEI dhe Kompanitë e Grupit. Lista e kontrolluesve përkatës të të dhënave dhe detajet e kontaktit të tyre mund të gjenden në tabelën më poshtë.

Nëse keni pyetje në lidhje me këtë njoftim privatësie ose dëshironi të na kontaktoni për ndonjë arsye në lidhje me përpunimin e të dhënave tona personale, ju lutemi na kontaktoni në detajet e kontaktit më poshtë.

Kontrolluesi i të dhënave	Detaje të Kontaktit
<p>Nëse ju (a) aplikoni, (b) ofroni shërbimet tuaja, ose blini produkte dhe shërbime nga, (c) vizitoni faqen e internetit të kompanive të mëposhtme ose filialeve/degëve të tyre, ajo kompani do të jetë kontrolluesi i të dhënave të të dhënave tuaja personale.</p>	
Produkte Automobilistike	
SEI Automotive Europe GmbH	<p>Gustav-Stresemann-Ring 1, 65189 Wiesbaden, Gjermani Telefoni: +49 (0) 611-1677-1800 Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave: E-mail: dataprotection@sei-ae.com</p>
SEWS-Cabind SpA	<p>Corso Pastrengo 40, 10093 Collegno (TO), Itali Telefoni: +(39)-011-4010611</p>
Sumitomo Electric Bordnetze SE	<p>Brandgehaege 11 38444 Wolfsburg-Hattorf, Gjermani Telefon: +(49)-5308-400-400 Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave: Email: datenschutzbeauftragter@sebn.com</p>
Sumitomo Electric Wiring Systems (Europe) Ltd	<p>Prospect House, Cemetery Road, Silverdale Newcastle-under-Lyme Staffordshire ST5 6PA, MB. Telefoni: +(44)-1782-664700</p>
Materiali industrial	
Sumitomo Electric Hardmetal Ltd.	<p>3 Paper Mill Drive, Redditch, Worcestershire, B98 8QJ, MB. Telefoni: +(44)-18-4434-2081</p>
Sumitomo Electric Hartmetall GmbH	<p>Konrad-Zuse-Rr. 9, 47877 Willich, Gjermani Telefoni: +(49)-2154-4992-0 Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave: Email: dataprotection@sei-ae.com</p>
Sumitomo Electric Hartmetallfabrik GmbH	<p>Industriestrasse 2, 73466 Lauchheim, Gjermani Telefoni: +49 (7363) 87-86 Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave: Sistemi i Menaxhimit të GS Email: gerald.saur@gsmanagement.de</p>
Sintewerke Herne GmbH	<p>Forellstraße 100, 44629 Herne, Gjermani Telefoni: +49 (0) 2323 201-0 Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave: Email: info@sinterwerke.com</p>

Sinterwerke Grenchen AG	Neckarsulmstrasse 20, 2540 Grenchen, Zvicër Telefoni: +41 (0) 32 655 6868 Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave: Email: info@sinterwerke.com
Sumitomo Electric Sintered Components (Gjermani) GmbH	Dischinger Rr. 1, 02763 Mittelherwigsdorf, Gjermani Telefoni: +(49)-3583-51840
Produkte elektronike	
Sumitomo Electric Europe Ltd.	Unit 220, Centennial Park, Elstree, Hertfordshire, WD6 3SL, MB Telefoni: +(44)-208-953-8118
Sumitomo Electric Schrumpf-Produkte GmbH	Oststrasse 89, 22844 Norderstedt, Gjermani Telefon: +(49)-40-5265010 Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave: Email: dataprotection@sei-ae.com
SEI Identification Solutions Ltd.	Pysons Road Industrial Estate, Broadstairs, Kent CT10 2LQ, MB Telefoni : +(44)-1792-487-290
SEI Interconnect Products (Europe) Ltd.	Axis 10 Akxis Court, Mallard Way Swansea SA7 0AJ, MB Telefoni: +(44)-1792-487-290
SEI Interconnect Products (Hungary), Kft.	5142, Alattyán, Jászapáti út 1, Hungary Telefoni : +(36)-57-561-200
Heinrich Thulesius GmbH & Co. KG	Zum Panrepel 15, 28307 Bremen, Gjermani Telefoni: +49 (0) 421 / 4895-0
Financa dhe Shërbime Ligjore	
Sumitomo Electric Finance UK Ltd.	Octagon Point, St Paul's, 5 Cheapside, Londër, EC2V 6AA Telefoni: +(44)-20-7073-7800
Për të gjitha përpunimet e tjera në kontekstin e produkteve dhe shërbimeve të SEI:	
Sumitomo Electric Industries, Ltd.	4-5-33, Kitahama, Chuo-ku, Osaka, Japoni Formulari i kërkesës: ju lutemi klikoni këtu .

Data e hyrjes në fuqi: 14 prill 2023

Përditësimi i fundit: 12 qershor 2023